



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 23.03.2021

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në në Vendimin nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

I. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM:

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

Detyrat kryesore:

1. Asiston në përgatitjen e auditimeve në përputhje me procedurat e auditimit;
2. Asiston në analizimin dhe raportimin mbi saktësinë dhe efektivitetin e sistemit financiar, operacional, kontrollin menaxherial dhe veprimtarinë;
3. Asiston në hartimin e projekteve, raporteve, raporteve finale bazuar në standartet e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit “Master Profesional”, në Shkenca Ekonomike ose Juridike.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

1. Njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,
2. Njohuri mbi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike,
3. Njohuri mbi Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural
4. Njohuri mbi Ligjin “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
5. Njohuri mbi Ligjin “Për funksionimin dhe organizimin e administratës publike”;

6. Njohuri mbi Ligjin “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
7. Njohuri mbi Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave;
8. Njohuri mbi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”;
9. Njohuri mbi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për RSH, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (IPARD)";

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 26.03.2021, ora 14.00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL